

Banka e Shqipërisë

# TENDENCAT NË KREDITIM

TREMUJORI III - 2014

*SOFIKA NOTE*

DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE

TETOR 2014

Pikëpamjet e shprehura në këtë material janë të autores dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bankës së Shqipërisë.



# P Ë R M B A J T J A

PËRMBLEDHJE	4
1. PANORAMË E PËRGJITHSHME	5
2. KREDIA PËR BIZNESE	8
3. KREDIA PËR INDIVIDË	12
4. ÇMIMI I KREDISË DHE KUSHTET E TJERA TË KREDITIMIT	15
5. TENDENCAT E KREDITIMIT NË VENDET E RAJONIT	18

## PËRMBLEDHJE

Aktiviteti ndërmjetësues i bankave është karakterizuar nga përshpejtim i ndërmjetësimit në lekë dhe ngadalësim i mëtejshëm i atij në valutë. Depozitat në lekë janë ngadalësuar, duke çuar në një shkallë më të lartë të përdorimit të tyre në kreditim. Nga ana tjetër, depozitat në valutë vazhdojnë të rriten, në një kohë kur kërkesa e pakët për kredi nga ekonomia është e orientuar drejt monedhës vendase. Kjo ka rezultuar në likuiditet të tepërt të sistemit bankar në valutë dhe investimin e tij jashtë vendit.

Kredia për biznese ka nxitur rritjen e kredisë në muajt korrik dhe gusht. Ajo ka financuar si nevojat afatshkurtra të bizneseve për likuiditet, ashtu edhe investimet e tyre. Megjithatë, ajo ka qenë e përqendruar në dy sektorë të ekonomisë dhe është lëvruar nga pak banka të sistemit. Sinjale pozitive vijnë nga treguesit e vrojtimit të bankave dhe të biznesit, të cilët sugjerojnë një kërkesë të shtuar për kredi dhe përmirësim të ndjesisë së bizneseve. Nga ana tjetër, bankat i kanë mbajtur kushtet e kreditimit të pandryshuara për bizneset në tremujorin e tretë të vitit. Të njëjtat tendenca pritet të vërehen edhe në tremujorin e ardhshëm. Ecuria e kredisë për biznese mbetet e brishtë, për sa kohë ajo nuk po rritet me bazë më të gjerë.

Kredia për individë ka rezultuar e plogësht, si në krahasim me një vit më parë, ashtu edhe me pjesën e parë të vitit. Bankat raportojnë për kërkesë të shtuar të individëve për kredi dhe lehtësim më të madh të kushteve krahasuar me bizneset. Edhe treguesit e besimit konsumator rezultojnë të përmirësuar në tremujorin e tretë të vitit. Megjithatë, këto sinjale janë materializuar në mënyrë të pjesshme në ecurinë e kredisë për individë. Kërkesa e re e individëve është e orientuar drejt financimit të konsumit, dhe më pak drejt kredisë hipotekare, pavarësisht produkteve më tërheqës për këtë të fundit.


Normat e interesit të kredisë kanë rënë më tej në muajt korrik dhe gusht. Rënia ka qenë më e ndjeshme për kreditë në lekë, ndërkohë që normat e interesit për kredinë në valutë kanë shfaqur rënie më të përmbajtur. Reduktimi i normave të interesit vërehet në pothuajse të gjitha llojet e kredive. Diferenca mes normave të interesit në lekë dhe atyre në valutë është ngushtuar, duke nxitur kreditimin më të madh në monedhën vendase. Sa u takon kushteve të tjera të kreditimit, bankat kanë lehtësuar pjesën më të madhe të tyre, si për bizneset, ashtu edhe për individët.

Analiza e ecurisë së kredisë për sektorin privat në vendet e rajonit tregon për përmirësim të saj në nivel mesatar, e nxitur nga rritja e kredisë për individë. Ndërkohë, mes vendeve ka ende divergjenca. Në këtë krahasim rajonal, Shqipëria dallon nga pjesa më e madhe e vendeve, pasi është kredia për biznese ajo që po nxit rimëkëmbjen e kredisë për sektorin privat. Shqipëria renditet mbi mesataren e rajonit për ecurinë e kredisë për biznese, por nën të për ecurinë e kredisë për individë.

# 1. PANORAMË E PËRGJITHSHME


Aktiviteti financiar i bankave është karakterizuar nga rritja e mëtejshme e ndërmjetësimit në lekë dhe reduktimi i ndërmjetësimit në valutë. Kjo tablo reflekton orientimin në lekë të kërkesës së pakët për kredi, të nxitur nga lehtësimi i kushteve monetare. Nga ana tjetër, zhvillimet në depozita kanë shfaqur dinamikë të ndryshme. Ato vazhdojnë të regjistrojnë rritje të ulët vjetore, të nxitura kryesisht nga rritja e depozitave në valutë.

Ndërmjetësimi financiar i bankave në muajt korrik dhe gusht është karakterizuar nga tendenca më pozitive se në pjesën e parë të vitit. Ai ka reflektuar një kërkesë lehtësisht më të lartë për kredi, të orientuar kryesisht në monedhën vendase. Rritja vjetore e kredisë kaloi në territor pozitiv në muajin korrik dhe në gusht shënoi 2.2%. Përtej shuarjes së efektit bazë si rrjedhojë e reduktimit të fortë të portofolit në muajin korrik të vitit të kaluar, përmirësimi i rritjes vjetore ka reflektuar edhe dinamikë më të gjallëruar në 5 muajt e fundit. Rikuperimi i kreditimit mbetet gradual e ende i brishtë, dhe pritet të bëhet më i qëndrueshëm me përmirësimin e mëtejshëm të aktivitetit ekonomik dhe reduktimin e pasigurive për të ardhmen të agjentëve ekonomikë dhe të bankave. Ndërkohë, depozitat vazhdojnë të regjistrojnë rritje të ulëta vjetore, të nxitura kryesisht nga depozitat në valutë. Në fund të muajit gusht, ato janë 2.3% më të larta se një vit më parë <sup>1</sup>.



<sup>1</sup> Përfshihen edhe depozitat jashtë përkufizimit të parasë së gjerë. Nga këndvështrimi i bankave, ato shërbejnë njësoj për të financuar aktiviteti kreditues.

Aktiviteti ndërmjetësues vazhdon të ngadalësohet në monedhat e huaja, si rrjedhojë e tkurrjes së kredisë në valutë. Raporti kredi/depozita në valutë qëndron në 64.5% në muajin gusht, duke rënë me 1.4 p.p. kundrejt tremujorit të dytë të vitit dhe me 3.8 p.p. kundrejt një viti më parë. Paralelisht me këtë zhvillim, aktiviteti ndërmjetësues në lekë është rritur më tej. Në fund të muajit gusht, raporti kredi/depozita në monedhën vendase rezultoi 41.6%, duke shënuar një rritje prej 0.9 p.p. kundrejt tremujorit të dytë të vitit dhe prej 2.5 p.p. kundrejt një viti më parë. Kjo ecuri ka reflektuar përshtypimin e kredisë në lekë, në një kohë që një pjesë e kursimeve të individëve janë zhvendosur në letra me vlerë të qeverisë. Raportet e kredisë dhe depozitave ndaj PBB-së<sup>2</sup> janë shfaqur të qëndrueshme gjatë vitit, duke u luhatur mesatarisht në vlerat 39.2% dhe 74.2%.




Rritja e depozitave në lekë ka qenë e ngadaltë gjatë vitit 2014. Depozitat në lekë të përfshira në parinë e gjerë kanë vijuar të bien në terma vjetorë, duke u tkurrur me 1.8% në muajin gusht. Ndryshimet strukturore në depozita vazhdojnë. Një pjesë e tyre janë zhvendosur në depozita me afat maturimi më të madh se dy vjet, të cilat nuk përfshihen në llogaritjet e parësë së gjerë. Duke marrë parasysh edhe depozitat e papërfshira në parinë e gjerë, rritja vjetore e depozitave në lekë shënoi 0.3% në muajin gusht, duke u përmirësuar në krahasim me tremujorin e dytë të vitit. Përveç depozitave, bankat janë financuar edhe nga Banka e Shqipërisë, nëpërmjet marrëveshjeve të anasjella të riblerjes.

Bankat kanë qenë më aktive në kreditimin në lekë të ekonomisë gjatë vitit 2014. Ky trend është mbartur edhe në muajt korrik dhe gusht. Rritja vjetore e kredisë në lekë në fund të muajit gusht shënoi 6.7%, nga 4.2% që shënonte në fund të tremujorit të dytë të vitit. Financimi në lekë është rritur, si për bizneset ashtu edhe për individët, i nxitur nga reduktimi më i shpejtë i normave të interesit të kredive në monedhën vendase. Bankat kanë vijuar të financojnë

<sup>2</sup> Vlerësim i stafit të DPM, bazuar në PBB-në reale dhe inflacionin.

edhe sektorin publik gjatë këtyre muajve. Investimet e tyre në letra me vlerë në monedhën vendase të qeverisë, në muajin gusht, janë 5.9% më të larta se një vit më parë. Zgjerimi i tyre në muajt korrik dhe gusht është përqendruar në instrumente me maturitet të larta.




Burimet e financimit të sistemit bankar në valutë, deri në muajin gusht të vitit 2014, kanë ruajtur ritmet e rritjes të shfaqura në dy vitet e mëparshme. Burimi i rritjes së tyre kanë qenë depozitat e rezidentëve me maturitet nën dy vjet, të cilat janë rritur ndjeshëm duke filluar nga muaji maj i këtij viti dhe, në fund të muajit gusht, rezultojnë 5.2% më të larta se një vit më parë. Krahas tyre, rritje kanë shënuar edhe depozitat e rezidentëve me maturim më të lartë se dy vjet. Thithja me madhe e depozitave në vend ka krijuar mundësinë e reduktimit të detyrimeve që bankat kanë ndaj jorezidentëve. Kështu, depozitat dhe kreditë nga jorezidentët, që përfaqësojnë kryesisht zëra financimi nga bankat mëma, kanë shënuar rënie gjatë këtij viti.

Kredia për ekonominë në valutë ka vazhduar të tkurret edhe në muajt korrik-gusht, por me norma më të ulëta se në pjesën e parë të vitit. Në fund të gushtit, ajo është 0.7% më e ulët se një vit më parë. Ecuria e saj është ndikuar nga një kërkesë e ulët për kredi, veçanërisht për investime, dhe nga zhvendosja e aktivitetit kreditues drejt monedhës vendase. Likuiditetin e tepërt në valutë, bankat vazhdojnë ta investojnë jashtë, në formën e investimeve në letra me vlerë apo edhe kredi për jorezidentët.

## 2. KREDIA PËR BIZNESE

*Kredia për biznese ka shfaqur ecuri të mirë në muajt korrik dhe gusht, si për qëllime likuiditeti, ashtu edhe për qëllime investimi, por ky përmirësim mbetet i segmentuar sa i përket sektorëve të ekonomisë dhe bankave kredituese. Bankat raportojnë për kushte të pandryshuara të financimit në tremujorin e tretë të vitit dhe kërkesë të shtuar të bizneseve. Këto tendenca pritet të mbarten edhe në tremujorin e katërt të vitit. Sinjalet pozitive të marra nga vrojtimet e bankave dhe të bizneseve nuk janë reflektuar ende në një përmirësim me bazë të gjerë të kredisë për biznese.*

Rritja vjetore e kredisë për biznese i është kthyer ritmeve pozitive në muajt korrik dhe gusht, duke shënuar përkatësisht 0.9% dhe 3.2% në këta dy muaj<sup>3</sup>. Rikuperimi i rritjes vjetore ka qenë i pranishëm si në segmentin e kredisë për likuiditet, ashtu edhe në atë të kredisë për investime. Në fund të muajit gusht, rritjet vjetore të këtyre dy portofoleve shënuan përkatësisht 2.8% dhe 2.3%<sup>4</sup>. Kredia në lekë e bizneseve ka vijuar të shfaqë ecuri të mirë, çka është reflektuar në ritme më të larta të rritjes vjetore, prej 8.5% në muajin gusht. Gjithashtu, edhe kredia në valutë e bizneseve ka shënuar rritje vjetore pozitive, prej 0.6%, pas një periudhe gati dyvjeçare tkurrijeje.




<sup>3</sup> Që prej muajit korrik 2014, është shuar efekti bazë në normat e rritjes së kredisë për biznese, si rrjedhojë e shitjes së një kredie në muajin korrik të vitit të kaluar. Kjo shitje ka prekur normat vjetore të rritjes së kredisë për investime, ato të kredisë për biznese në valutë dhe ato të kredisë totale për biznese gjatë periudhës korrik 2013-qershor 2014.

<sup>4</sup> Të dhënat për kredinë për biznese dhe individë sipas qëllimit të përdorimit nuk përfshijnë interesat e përllogaritur dhe, për këtë arsye, rritjet vjetore të tyre nuk janë plotësisht të përputhshme me rritjen vjetore të kredisë për biznese dhe individë të raportuar në statistikatat monetare.




Zhvillimet mujore në kredinë për biznese kanë qenë pozitive në muajt korrik dhe gusht. Ajo u rrit me rreth 9 miliardë lekë, pas një ecurie të plogësht në gjashtë muajt e parë të vitit. Ky financim ishte kryesisht në formën e kredisë për investime, në lekë dhe valutë, dhe të kredisë për likuiditet në valutë. Kredia për investime e dhënë gjatë këtyre dy muajve ka financuar blerjen e makinerive dhe pajisjeve, si dhe të ambienteve të punës (pasuri të paluajtshme). Me gjithë përmirësimet në muajt e fundit, rritja e financimit të bizneseve është ende e brishtë, dhe qëndrueshmëria e këtyre zhvillimeve pozitive mbetet për t'u konfirmuar në muajt e ardhshëm. Kredia e re, duke përjashtuar kredinë *overdraft*<sup>5</sup>, mbetet ende në nivele të ulëta. Në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ajo është rreth 8% më e ulët.



Fluksi i shtuar i kredisë për biznese në muajt korrik dhe gusht ka qenë i përqendruar në dy sektorë të ekonomisë. Bankat kanë rritur financimin për sektorin e industrisë (nxjerrëse dhe përpunuese) dhe për sektorin e tregtisë. Rritje ka shënuar edhe financimi për sektorin e bujqësisë, por pesha e tij në totalin e kredisë për biznese është e vogël, rreth 1.7%, pavarësisht kontributit të rëndësishëm që ky sektor jep në rritjen e aktivitetit ekonomik. Një pjesë e mirë e bankave në vend po shfaqin interes në rritje për këtë sektor, por informaliteti i lartë që e karakterizon atë dhe rreziku që shoqëron aktivitetin bujqësor ndikojnë ndjeshëm në kujdesin e tyre për t'u ekspozuar në këtë sektor. Skemat mbështetëse të financimit për sektorin e bujqësisë të ofruara nga institucione të huaja apo publike kanë ndihmuar rritjen e financimit të bankave për sektorin e bujqësisë.


<sup>5</sup> Kreditë *overdraft* karakterizohen nga mbyllje dhe rinovime të njëpasnjëshme gjë që rrit artificialisht kredinë e re, duke përfshirë edhe rinovimet e kredive ekzistuese.

Grafik 6. Ecuria e kredisë për biznese sipas sektorëve të ekonomisë



Pas lehtësimit të kryer në tremujorin e dytë të vitit, bankat nuk i kanë ndryshuar kushtet e kreditimit të bizneseve në tremujorin e tretë dhe presin t'i mbajnë ato thuajse në të njëjtat nivele edhe në tremujorin e katërt të vitit. Përqasja e bankave ndaj kreditimit të bizneseve ka qenë e njëtrajtshme në të gjitha segmentet, me një preferencë lehtësisht të shtuar për financimin e bizneseve të vogla dhe të mesme. Kreditimi i këtyre të fundit është shumë i dobishëm për mbështetjen e aktivitetit ekonomik, në një kohë kur tregu i bizneseve të mëdha konsiderohet i ngopur me financim. Nga ana tjetër, informaliteti i lartë në këtë segment dhe vështirësia në vlerësimin e rrezikut që mbart financimi i tij mbeten pengesë për rritjen e financimit bankar për këto biznese.

Grafik 7. Ndryshimet në ofertën (majtas) e kërkesën (djathtas) për kredi të bizneseve, dhe faktorët që kanë ndikuar ato, balancë përgjigjesh, p.p.



Krahas balancave në përmirësim të bankave dhe politikave të Bankës së Shqipërisë, kushtet e kredisë për bizneset kanë reflektuar në një masë më të madhe rritjen e konkurrencës mes bankave. Situata makroekonomike dhe kreditë me probleme vazhdojnë të jenë faktorët që ndikojnë në sjelljen


konservatore të bankave ndaj financimit të bizneseve, por në një masë më të ulët në krahasim me tremujorët e mëparshëm.

Kërkesa e bizneseve për kredi vlerësohet lehtësisht e rritur në tremujorin e tretë të vitit dhe pritet të rritet më tej në tremujorin e katërt të vitit. Sipas bankave, ajo është nxitur kryesisht nga kushte më të favorshme kreditimi dhe një situatë ekonomike në përmirësim. Informacioni i filtruar nga treguesit e besimit të bizneseve mbështet gjithashtu vlerësimin për një përmirësim të aktivitetit ekonomik në tremujorët e ardhshëm, dhe ndoshta paralelisht me të, një rritje të kërkesës për kredi nga bizneset. Megjithatë, duhet vërejtur se deri tani, përmirësimi i treguesve të besimit dhe të atyre të vrojtimit të kredisë nuk ka gjetur ende materializim me bazë të gjerë në ecurinë e kredisë për biznese.

### 3. KREDIA PËR INDIVIDË

Ecuria e kredisë për individë vazhdon të jetë e plogësht. Përmirësimi i rritjes vjetore të saj në muajin gusht i dedikohet më së shumti shuarjes së një efekti bazë, ndërkohë që zhvillimet mujore kanë qenë të dobëta. Bankat raportojnë për kushte të lehtësuara financimi dhe kërkesë të shtuar për kredi në tremujorin e tretë të vitit, por këto sinjale nuk janë materializuar ende në ecurinë faktike të kredisë.

Rritja vjetore e kredisë për individë është luhatur rreth nivelit 0% gjatë 12 muajve të fundit. Në fund të muajit gusht, ajo është 0.8% më e lartë se një vit më parë<sup>6</sup>. Kredia hipotekare vazhdon të shënojë rritje vjetore të ulët, ashtu si në muajt e mëparshëm. Ndryshimi vjetor i kredisë konsumatore rezultoi 3.0% në muajin gusht, duke iu kthyer ritmeve pozitive. Brenda portofolit të kredisë konsumatore, financimi i konsumit të qëndrueshëm ka shfaqur trend rritës në 12 muajt e fundit, duke balancuar rënien e llojeve të tjera të kredisë konsumatore (overdraft dhe kredi konsumatore për mallra të paqëndrueshme).




Zhvendosja e kreditimit të individëve drejt monedhës vendase vazhdon të jetë e evidente. Rritja vjetore e kredisë në lekë është forcuar në 6.0% në muajin gusht, ndërkohë që kredia në valutë vazhdon të tkurret në terma

<sup>6</sup> Në muajin gusht të këtij viti, pushoi së vepruari efekti bazë, si rrjedhojë e shitjes së një pjese të portofolit të kredisë për individë nga një bankë e sistemit. Portofoli i shitur ishte kredi për financimin e konsumit në lekë, dhe efekti i shitjes ka prekur rritjet vjetore të kredisë për konsum, të kredisë për individë në lekë dhe të kredisë totale për individë gjatë periudhës gusht 2013 – korrik 2014.

vjetorë dhe, në muajin gusht, rezulton 3.9% më e ulët se një vit më parë. Kjo zhvendosje vërehet në të dy segmentet kryesore të kredisë për individë: në kredinë hipotekare dhe në atë konsumatore. Krahas politikave të bankave për përputhjen e monedhës së kredisë me atë të të ardhurave, edhe ngushtimi i ndjeshëm i diferencës mes normave të interesit të kredisë në lekë dhe atyre në valutë ka ndikuar në këtë zhvendosje.


Grafik 9. Zhvillimet mujore në kredinë për individë



Shënim: Ndryshimet mujore nuk përmbajnë efektin e riklasifikimit të përmendur më sipër. Gjithashtu, fluksneto në grafikun djathtas janë të rregulluara për pastrimet e bilancit, si p.sh. fshirjet dhe shitjet e kredive. Burimi: Banka e Shqipërisë.

Dinamika mujore e kredisë për individë ka rezultuar e dobët në periudhën korrik–gusht. Teprica e saj është reduktuar me 0.2 miliardë lekë në këta muaj, duke reflektuar kryesisht rënien e kredisë hipotekare. Kredia e re për individë vazhdon të mos shfaqë shenja të qarta gjallërimi. Niveli mesatar i saj dy muaj e fundit është pranë niveleve të vitit të kaluar dhe të pjesës së parë të vitit. Në të njëjtën kohë, individët kanë shfaqur tendencën e shlyerjes më të shpejtë të detyrimeve të tyre ndaj bankave, veçanërisht të atyre në monedhë të huaj.

Grafik 10. Ndryshimet në ofertën (majtas) dhe kërkesën (djathtas) për kredi të individëve dhe faktorët që kanë ndikuar ato, balancë përgjigjesh, p.p.



Shënim: Balancat pozitive/negative nënkuptojnë lehtësim kushtesh (ritje të kërkesës)/shtrëngim kushtesh (rënie të kërkesës). Tek faktorët e ofertës, faktorë bilanci llogaritet si mesatare e thjeshtë e rezultateve për situatën e likuiditetit dhe atë të kapitalit. Në mënyrë të ngjashme, janë mesatarizuar edhe ndryshimet e dy faktorëve: gjendja financiare e individëve dhe kreditit me probleme, të cilët kanë ecuri të ngjashme. Tek faktorët e kërkesës, nevoja për financim mesatarizon nevojat për financim konsumi dhe për blerje pasurish të paluajtshme. Burimi: Banka e Shqipërisë.


Bankat kanë vazhduar të ndjekin një përjasje pozitive ndaj kreditimit të individëve. Rritja e konkurrencës mes bankave, politikat e Bankës së Shqipërisë dhe situata më e favorshme në tregun e pasurive të paluajtshme, kanë nxitur lehtësimin e mëtejshëm të kushteve të kreditimit për individët në tremujorin e tretë të vitit. Nga ana tjetër, gjendja financiare e individëve dhe niveli i kredive me probleme mbeten faktorë shqetësues për bankat, duke ndikuar në ruajtjen e sjelljes përzgjedhëse të tyre në kreditimin e individëve.

Bankat raportojnë për kërkesë të shtuar për kredi nga individët, të orientuar më së shumti drejt financimit të konsumit. Pavarësisht ofrimit të kushteve konkurruese nga bankat në segmentin e kredisë hipotekare, individët hezitojnë të ndërmarrin investime afatgjata. Rritja e kërkesës për kredi është nxitur nga lehtësimi i kushteve të kreditimit, në reflektim të politikës së ndjekur nga Banka e Shqipërisë. Megjithatë, kërkesa mbetet e kufizuar në nevojat urgjente dhe afatshkurtra për financim. Sikurse edhe tek kredia për biznese, sinjalet pozitive nga vrojtimi i aktivitetit kreditues dhe përmirësimi i besimit konsumator, matur nga vrojtimet e konsumatorit, nuk janë materializuar ende në përmirësim të dukshëm të kredisë për individë.

## 4. ÇMIMI I KREDISË DHE KUSHTET E TJERA TË KREDITIMIT

Normat e interesit të kredisë vazhdojnë të bien në muajt korrik dhe gusht, veçanërisht për kreditë në monedhën vendase. Diferenca mes tyre dhe normave të interesit të depozitave është ulur për lekun dhe është rritur për monedhën euro. Normat e interesit të kredisë në lekë u janë afruar atyre në euro, duke nxitur më tej kreditimin në monedhën vendase. Krahas reduktimit të normave të interesit, bankat raportojnë edhe për lehtësim të pjesës më të madhe të kushteve të tjera të kreditimit gjatë tremujorit të tretë të vitit.

Normat e interesit të kredisë kanë vijuar të bien edhe në muajt korrik dhe gusht. Rënia e tyre ka qenë e ndjeshme për kreditë në monedhën vendase, dhe më e lehtë për kreditë në euro. Normat mesatare të interesit të kredisë mbeten të luhatshme muaj pas muaji, si rrjedhojë e ndikimit të normave të interesit për kredi të veçanta, në kushtet e niveleve të ulëta të kredisë së re.




Norma mesatare e interesit të kredisë në lekë rezultoi 8.5% në muajt korrik dhe gusht, duke rënë me 0.6 p.p. kundrejt vlerës mesatare të regjistruar në tremujorin e dytë të vitit. Në krahasim me një vit më parë, ajo është mesatarisht 1.7 p.p. më e ulët. Reduktimi i normave të interesit të kredisë në muajt korrik dhe gusht ka çuar në reduktimin e *spread*-eve dhe të marzheve<sup>7</sup> të interesit në këta muaj. Megjithatë, diferenca e tyre ndaj normave të interesit të depozitave dhe të bonove të thesarit është më e lartë krahasuar më një vit më parë, si rrjedhojë e rënies më të shpejtë të këtyre të fundit.

<sup>7</sup> *Spread*-i shpreh diferencën mes normës së interesit të kredisë dhe normave referencë për kredinë (bono thesari 12-mujore për lekun dhe euribor 12-mujor për euron). Marzhi shpreh diferencën mes normave të interesit të kredisë dhe atyre të depozitave.

Norma e interesit për kredinë në euro rezultoi mesatarisht 6.7% në muajt korrik dhe gusht, duke rënë lehtësisht kundrejt tremujorit të mëparshëm. Në krahasim me një vit më parë, ajo është mesatarisht 0.4 p.p. më e ulët. Nga ana tjetër, normat e interesit të depozitave në euro kanë shfaqur një trend të fortë rënës, duke arritur nivelet e normave të interesit për euron në tregun ndërbankar evropian. Reduktimi i normës së interesit që bankat paguajnë për depozitat në euro reflekton rritjen e likuiditetit të bankave në këtë monedhë, në kushtet kur mundësitë e investimit të tij brenda vendit janë të kufizuara. Si rrjedhojë e këtyre zhvillimeve, marzhi i normave të interesit të kredisë kundrejt atyre të depozitave është rritur. Ndërkohë, *spread*-i kundrejt euribor-it ka rënë lehtësisht, duke reflektuar rënien më të lehtë të tij në muajt e fundit.


Rënia më e shpejtë e normave të interesit për kreditë në lekë kundrejt atyre në euro është reflektuar në ngushtimin e vazhdueshëm të diferencës mes të dyjave. Kështu, në muajt korrik dhe gusht, kjo diferencë rezultoi mesatarisht 1.8 p.p., duke rënë me 0.5 p.p. dhe me 1.3 p.p. përkatësisht kundrejt tremujorit të mëparshëm dhe të njëjtit tremujor të një viti më parë. Ky zhvillim ka qenë edhe një ndër faktorët kryesorë që ka nxitur orientimin e kërkesave për kredi drejt monedhës vendase. Zhvendosja e kredisë nga monedhat e huaja drejt asaj vendase mbështet qëndrueshmërinë e sistemit financiar dhe krijon premisat për rritjen e eficiencës së politikës monetare.



Duke iu kthyer ecurisë së normave të interesit në lekë, reduktimi i tyre vërehet në thuajse të gjithë segmentet e kredisë, në afat të shkurtër dhe të gjatë. Kështu, analiza e tyre sipas qëllimit të përdorimit për muajt korrik dhe gusht tregon për reduktim të normave mesatare të interesit të kredisë për biznese me rreth 1.6 p.p. kundrejt një vitit më parë dhe me rreth 0.4 p.p. kundrejt tremujorit të dytë të vitit. Rënia e tyre është më e dukshme në segmentin e investimeve. Për të njëjtën periudhë, norma mesatare e kredisë për individë ka rënë me rreth 2.0 p.p. dhe 1.1 p.p. përkatësisht kundrejt një viti më parë dhe tremujorit të kaluar. Rënia është më e dallueshme në kredinë konsumatore për



mallra të paqëndrueshme dhe në atë hipotekare. Për kredinë sipas qëllimit në monedhën euro, reduktimi është më i vogël dhe më i segmentuar.




Krahas reduktimit të normave të interesit, bankat raportojnë edhe lehtësim të kushteve të tjera të kreditimit në tremujorin e tretë të vitit. Për bizneset, bankat kanë lehtësuar më tej kërkesat për kolateral dhe kanë rritur afatin e maturimit të kredive të ofruara. Ndërkohë, gjatë kësaj periudhe, bankat kanë riparë në kahun shtrëngues madhësinë e financimit për bizneset.

Në kushtet e kredisë për individë, madhësia e kredisë, maturiteti i saj, dhe raporti këst/të ardhura vazhdojnë të veprojnë në kahun lehtësues. Ndërkohë, si edhe në tremujorin e mëparshëm, bankat mbeten të kujdesshme në kërkesat e tyre për mbulimin me kolateral të kredive të dhëna.

## 5. TENDENCAT E KREDITIMIT NË VENDET E RAJONIT<sup>8</sup>

Në rajon, kredia për sektorin privat shfaqet e përmirësuar gjatë vitit 2014, e nxitur kryesisht nga rritja e qëndrueshme e kredisë për individë. Megjithatë, ky përmirësim është i segmentuar dhe i udhëhequr vetëm nga një pjesë e vendeve. Në këtë krahasim rajonal, ecuria e aktivitetit kreditues në Shqipëri është afër mesatares së rajonit. Por, Shqipëria dallon nga trendi i përgjithshëm - përmirësimi i aktivitetit kreditues të saj udhëhiqet nga kredia për biznese dhe jo nga ajo për individë.

Zhvillimet në kredinë për biznese në rajon tregojnë për një trend përmirësues të rritjes së saj në terma mesatarë. Në fund të muajit gusht të këtij viti, ndryshimi mesatar vjetor i kredisë për biznese rezulton 0.2%, nga -1.1% në fund të vitit të kaluar. Brenda kësaj ecurie të përgjithshme, ecuria e kredisë për biznese mes vendeve mbetet e ndryshme. Kështu, në Maqedoni, Poloni dhe Bullgari, rritja vjetore e kredisë për biznese vazhdon të jetë pozitive dhe më e lartë se në fund të vitit 2013. Në Shqipëri, janë regjistruar norma pozitive të ndryshimit vjetor të kredisë për biznese, duke pasqyruar një situatë të përmirësuar kundrejt vitit të kaluar dhe një renditje mbi mesataren e rajonit. Në rastin e Hungarisë, Kroacisë, Rumanisë dhe Serbisë, stoku i kredisë për biznese vazhdon të tkurret edhe gjatë vitit 2014, në disa raste me normë edhe më të lartë se në vitin e kaluar.



<sup>8</sup> Në këtë material, kredia për vendet e rajonit është analizuar në terma realë, pra duke përfshirë efektin e kursit të këmbimit dhe të inflacionit. Gjithashtu, edhe mesatarja e rajoni është llogaritur si mesatare e ponderuar. Për këtë arsye, shifrat konkrete nuk janë të krahasueshme me analizën krahasuese të prezantuar në materialin e publikuar në muajin korrik.

Kredia për individë në vendet e rajonit shfaq një ecuri përgjithësisht më të mirë se ajo e bizneseve, edhe duke iu referuar viteve të mëparshëm. Pothuajse në asnjë nga vendet nuk vërehet përkeqësim i ndryshimeve vjetore. Edhe në vendet ku ky portofol vazhdon të tkurret, kjo po ndodh përgjithësisht me norma më të ulëta se kredia për biznese. Në terma mesatarë, rritja reale e kredisë për individë në vendet e rajonit është përmirësuar në 3.0%, nga 2.2% që shënonte në fund të vitit 2013. Performancë veçanërisht të mirë ka shfaqur kredia për individë në Maqedoni dhe Poloni. Edhe në Serbi dhe Republikën Çeke, kredia për individë vazhdon të shënojë norma pozitive të rritjes vjetore. Në rastin e Shqipërisë, rritja vjetore e kredisë për individë ka shënuar vetëm një përmirësim të lehtë kundrejt dy viteve të mëparshëm dhe është nën mesataren e rajonit. Në pjesën tjetër të vendeve, kredia për individë vazhdon të tkurret edhe në vitin 2014, me të njëjtën normë, si në Kroaci, ose me hap më të moderuar, si në Rumani dhe Hungari.